



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 57-të, të mbajtur më 21.12.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-3070 / 1 nga 27.08.2021 , e formuar pas denoncimit të dorëzuar për shkelje të ndalimeve nga Kodi Zgjedhor gjatë Zgjedhjeve Lokale 2021, _07179 SV 2021, 9 NDËRPRITET.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK-ja përcaktoi se pohimet në nga denoncimi nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 112-3070/1 të datës 27.08.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur -----, më datë 27.08.2021 është dorëzuar denoncim për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe konflikt interesi gjatë Zgjedhjeve Lokale 2021 për të cilën është formuar lënda 12-3070/1 datë 27.08.2021.

Pas shqyrtimit të ankesës, KSHPK-ja konstatoi se pas të njëjtës nuk do të veprojnë sipas nenit 33 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, për shkak se "Ankesa" nuk është dorëzuar nga Organizatori i fushatës zgjedhore, dhe të vazhdojë të veprojnë në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, bazuar në denoncimin e pranuar për dyshime për korrupsion dhe shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor.

Në denoncim, parashtruesi pretendon akuza kundër disa institucioneve buxhetore për shkelje të nenit 8-a paragrafi (1) pika (3) të Kodit Zgjedhor dhe nenit 34 paragrafi (1) alineja (3) të

Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konflikti i Interesit për shkak të publikimit të disa shpalljeve për punë në ditën e shpalljes së zgjedhjeve vendore 2021 dhe në ditët në vijim. Përkatësisht, sipas neneve të përmendura - nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve si dhe nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të komunës ose anëtarëve të këshillit, gjegjësisht deri në konstituimin e këshillit të komunave dhe qytetit të Shkupit nuk mund:

- të iniciojë procedurë për punësim të personave të rinj ose procedurë për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionet shtetërore dhe publike, dhe procedurat e nisura pezullohen, përveç rasteve urgjente dhe të ngutshme.

Në vazhdim të denoncimit thuhet se ndonëse ka pasur shpalljetë tjera, theksohen: shpallja me numër 561/2021 Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, shpallja 586/2021 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Shpallja 565/2021, 575/2021 dhe 576/2021 Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në rastin e hapur, KSHPK-ja iu drejtua institucioneve të lartpërmendura, si dhe Agjencisë për Administratë me kërkesë për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve për shpalljeve të publikuara dhe nëse ato janë dhënë në pritje. Nga përgjigjet e dorëzuara me dokumentacion të bashkangjitur nga institucionet mund të konstatohet si vijon:

- Shpallja publike me numër 561/2021 e publikuar për nevojat e Ministrisë së Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive është publikuar më 05.08.2021. Me kërkesë të ministrisë, afati i aplikimit është shtyrë edhe për pesë ditë të tjera. Pas skadimit të afatit për aplikim për shpalljen publike, Agjencia për Administratë ka nxjerrë Vendim për shtyrjen e procedurës së filluar për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim të nëpunësve administrativë me numër 10-1893/6 nga 25.08.2021;

- Shpallja publike me numër 565/2021 për nevojat e Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është publikuar më 06.08.2021. Pas skadimit të afatit për aplikim për shpalljen publike, Agjencia për Administratë ka nxjerrë Vendim për shtyrjen e procedurës së filluar për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim të nëpunësve administrativë me numër 10-1881/4 nga 23.08.2021;

- Shpallja publike me numër 575/2021 për nevojat e Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është publikuar më 06.08.2021. Pas skadimit të afatit për aplikim për shpalljen publike, Agjencia për Administratë ka nxjerrë Vendim për shtyrjen e procedurës së filluar për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim të nëpunësve administrativë me numër 10-1877/3 nga 23.08.2021;

- Shpallja publike me numër 576/2021 për nevojat e Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është publikuar më 06.08.2021. Pas skadimit të afatit për aplikim për shpalljen publike, Agjencia për Administratë ka nxjerrë Vendim për shtyrjen e procedurës së filluar për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim të nëpunësve administrativë me numër 10-1876/3 nga 23.08.2021;

- Shpallja publike me numër 586/2021 për nevojat e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është publikuar më 06.08.2021. Pas skadimit të afatit për dorëzimin e shpalljes publike, Agjencia për Administratë ka nxjerrë Vendim për shtyrjen e procedurës së filluar për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim të nëpunësve administrativë me numër 10-1909/3 nga 23.08.2021.

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se procedurat e nisura pas shpalljeve për punësim ishin pezulluar, kështu që pretendimet nga denoncimi nuk vërtetohen dhe nuk ka elemente për veprime të mëtejshme, pas së cilës vendosi si në dispozitë të këtij vendimi. .

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR
Biljana Ivanovska